



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2646 Prot.

Tiranë, më 31.10 2025

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr. 148 dt. 31.10 2025

“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT NR.65, DATË 03.06.2025 TË SENATIT AKADEMIK “MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR KONKURS, REGJISTRIMIT TË FITUESVE, PËR CIKLIN E PARË, TË DYTË TË STUDIMEVE DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR TË DY CIKLET E STUDIMEVE, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026”

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 3/ç, nenin 38, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenin 7 paragrafi 3/ç dhe 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, Shkresën me nr.2620 prot., datë 30.10.2025 me lëndë: “Kërkese për ulje tarife studimi për programin e ciklit të dytë “Master Profesional”, të Departamentit të Sporteve Individuale, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Shkresën me nr.2620/1 prot., datë 30.10.2025 me lëndë: “Përcjellje kërkese për ulje tarife studimi për programin e ciklit të dytë “Master Profesional”, në “Trajner i përgatitjes Fizike”, të Dekanit të Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2025,

V E N D O S I :

1. Ndryshimit të Vendimit nr.65, datë 03.06.2025 të Senatit Akademik “Mbi miratimin e propozimit të tarifave të rregjistrimit për konkurs, rregjistrimit të fituesve, për ciklin e parë, të dytë të studimeve dhe tarifat e shkollimit për të dy ciklet e studimeve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës për vitin akademik 2025-2026”, për uljen e tarifës së studimit 50% të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” në “Trajner i përgatitjes Fizike”.
2. Ky ndryshim të reflektohet në tabelën nr.5, bashkëlidhur vendimit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.

4. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA



Prof. Dr. Arben KAÇURRI

Prof. Dr. Dhurata BOZO

Prof. Dr. Ferdinand MARA

Prof. Asoc. Klotilda VRENJO

Prof. Asc. Dr. Enkeleda Lleshi

Prof. Dr. Robert ÇINA

Laura Avdo

Dr. Aisel OSEKU

Prof. Asoc. Elton SPAHIU

Prof. Asoc. Fisnik BROVINA

Prof. Asoc. Kujtim KAPEDANI

Prof. Asoc. Oltiana PETRI

Prof. Asoc. Robert ÇITOZI